

No. 1654 Data 25.11.2024
GJILAN

Në mbështetje të nenit 17. dhe nenit 21. Të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, Komisioni i Auditimit i KRU "Hidromorava"-SH.A. në Gjilan, me datë 25.11.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

**Për anulim të konkursit publik
(Rishpallje e konkursit publik Nr.1481 i dt. 07.10.2024)**

Anulohet Konkursi Publik Nr.1481 i dt. 07.10.2024, i rishpallur për herë të tretë për pozitën Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidromorava"- SH.A, Gjilan.

Arsyetim

Komisioni i Auditimit i Kompanisë Rajonale të Ujësjetlësist "Hidromorava " -SH.A. në Gjilan, me rastin e rishpalljes së konkursit publik Nr 1481 i dt. 07.10.2024 (i shpallur për herë të tretë), për plotësimin e pozitës punuese Zyrtar i Auditimit të Brendshëm në KRU "Hidromorava"- SH.A. dhe Vendimit Nr.1580/1 të dt. 05.11.2024, për shtyrjen e afatit të konkursit të rishpallur për herë të tretë Nr.1482 të dt.07.10.2024, pas administrimit dhe shqyrtimit të aplikacioneve të kandidatëve në pajtim me nenin 17. dhe 21. të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, me ndryshim plotësim nga Ligji Nr.04/L-111 dhe Ligji Nr. 05/L-009, konstatoi se prej gjithsej gjashtë /6/ kandidatëve të cilët kanë aplikuar për këtë pozitë asnjëri prej tyre nuk i kanë plotësuar kriteret sipas konkursit të publikuar konform dispozitave të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Nga të cekurat si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Obligohet Sekretarja e Ndërmarrjes që të njoftoj NJPMNP, si dhe kandidatët që kanë aplikuar për pozitën e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm dhe i njejt vendim të publikohet në web-faqe të Ndërmarrjes.



Kryesuesja e Komisionit të Auditimit .

Ferdane Tahiri Sylejmani
(znj. Ferdane Tahiri Sylejmani)